



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BLERTA D. KAÇELI  
ADRESA Rr. "Myslym Shyri", Nr. 82,  
Tiranë  
TEL: 0682014123

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 723

Nr. koleksioni: 114

Tirane më 16/05/2022



A2022053720013592184



A2022053720013592184

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ITALIAN GLASSES LENSES" SH.P.K.**

Sot, më datë 16.05.2022, para meje Notere BLERTA D. KAÇELI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. "Myslym Shyri", Nr. 82, Tiranë, u paraqit personalisht:

**THEMELUESI:**

**Z. STEFANO TORELLI**, shtetas Italian, i biri i Rocco, lindur më 20/09/1971, në Chieti, dhe banues në Rr. "Ndre Mjeda", Kompleksi Rezidencial Magnet, pll.149, shk.2, Ap.21, Tiranë, mbajtës i pashaportes me Nr. YB2521021, lëshuar me dt. 06.02.2018, zotron 1 (nje) **kuotë** me vlerë të përgjithshme 1000 (një mijë) lekë, që përbën 100 (njëqindë) % të kapitalit të Shoqërisë "ITALIAN GLASSES LENSES" sh.p.k.;

i cili ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), në bazë të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (të ndryshuar) dhe ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (të ndryshuar).

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "ITALIAN GLASSES LENSES" SH.P.K.

**Neni 2 - Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombetare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "ITALIAN GLASSES LENSES" SH.P.K., është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 3 – Selia**

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, në Rr. "Kavajes", Kompleksi "Square 21", shk.2, kt.6, ap.20, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Shoqërisë.

**Neni 4 - Objekti i veprimtarisë**

Objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

- Tregti me shumicë dhe pakice e produkteve okulistike, ku përfshihen syze optike dhe ato të diellit, lente kontakti.
- Montimi i kornizave dhe xhamave optike, mirembajtje dhe riparimi i syzeve, gjithashtu dhe vizita mjeksore okulistike.
- Import-eksport të syzeve të diellit dhe optike, lente optike.
- Import dhe tregti me shumicë dhe pakice të Instrumentave optik.

STEFANO TORELLI  




A2022053720013592184

## Neni 5 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë "ITALIAN GLASSES LENSES" sh.p.k. është e pakufizuar.

## Neni 6 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 lekë (njemije leke).

Ortaku i vetem, **Z. Stefano Torelli**, është zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **1000 (një mijë) lekë, që përbën 100 (njëqindë) % të kapitalit të Shoqërisë "ITALIAN GLASSES LENSES" sh.p.k.**;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

## Neni 7 - Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## Neni 8 - Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga **Z. Stefano Torelli** sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5-vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

## Neni 11 - Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të secilit vit. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.


## Neni 12 - Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 13 - Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Akt Themelimi, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

STEFANO TORELLI  
  
Fq. 2



A2022053720013592184

### Neni 14 - Dispozita përfundimtare


Ky Akt Themelimi u redaktua në 3 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua nën për nën nga Ortaku i shoqërisë tregtare **“ITALIAN GLASSES LENSES” SH.P.K.**, dhe nënshkruhet prej tij në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale, pasi përmbajtja e aktit i'u përkthye prej përkthyesit **Z. Enid Zoto**, i biri i Dhimiter, lindur me dt. 15.08.1973, në Vlore dhe banues në Tiranë, Rr. "Muhamet Delli", Nr. 56, i njohur prej meje noteres prej Leternjoftimit Nr.037438412, nr.personal H30815039S, dt.09.07.2021, me zotesi të plote për të vepruar i cili zotron gjuhën italiane dhe nënshkroi gjithashtu në prezencën tim.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Notarinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Akti nënshkruhet dhe prej meje Noteres.

#### ***THEMELUESI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***“ITALIAN GLASSES LENSES” SH.P.K.***

*Stefano Toracci*  


**PERKTHYES**

**ENID ZOTO**

*Enid Zoto*  
  
Stamp: PERKTHYES ENID ZOTO 07/07/2021

**NOTER**

**BLERTA D. KAÇELI**

*Blerta D. Kaçeli*  
  
Stamp: NOTERJA BLERTA D. KAÇELI TIRANË

